

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Melanie Trump flet për raportin “e trazuar” me të birin: Është i lumtur që unë merrem me punët e mija
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/melanie-trump-flet-per-raportin-e-trazuar-me-te-birin-sh-te-i-lumtur-qe-une--i588518
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 10:52:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 10:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2935ba4b6292d3482f008521982e22ed0a8e50e5635a56b306cb2c965de21813
TEKSTI	3eb98cd16a2b2efee90e3beafc752a3d5744d3860107561f441a62eb75864024
PAMJA	ae9876505923dc4aa1f8fc3d826173716fcca6b187d5947ad960873a0799b347

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e03d4842a041b4e06688f6426215fa8518b14eb831d4199ea4a8340ad42f13cf
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2f94de55f91080d406fb9f0e4354ffa5a46214db9e0928186c4866f36bf6cd6f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e03d4842a041b4e06688f6426215fa8518b14eb831d4199ea4a8340ad42f13cf>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by



English



ie Melanie Trump flet për raportin “e trazuar” me të birin: Është i lumtur që unë merrem me punët e mijaSa janë rritur kontributet? 8-mujori, mbi 1.4 miliarde euro derdhet fundit

Melanie Trump flet për raportin “e trazuar” me të birin: Është i lumtur që unë merrem me punët e mija



26 Shtator 2026, 12:50Bota TEMA



Melania Trump ka folur rrallëherë për jetën e saj familjare, ndërsa këtë herë ka ndarë disa detaje për marrëdhënien me djalin e saj, Barron Trump, duke pranuar se koha që familja kalon së bashku është bërë gjithnjë e më e kufizuar.

Në një intervistë për “The Big Money Show” të Fox Business, Zonja e Parë e SHBA-së u pyet se si arrin të gjejë kohë për familjen, mes angazhimeve të saj publike dhe atyre të bashkëshortit, Presidentit Donald Trump.

Melania, 56 vjeç, tha se koha familjare duhet planifikuar paraprakisht, pasi të dy kanë axhenda të ngarkuara.

“Koha që kalojmë së bashku si familje është gjithnjë e më e kufizuar”, tha ajo, duke shtuar se Donald Trump mund të qëndrojë deri vonë në Zyrën Ovale.

Duke folur për Barron, 20 vjeç, i cili studion në Universitetin e Nju Jorkut (NYU), Melania tha se djali i saj tashmë është në një tjetër etapë të jetës.

“Barron tashmë është një i ri, kështu që ndonjëherë ndoshta është edhe i lumtur që unë thjesht të merrem me punët e mia. Dhe kjo është në rregull”, u shpreh ajo.

Deklaratat e saj vijnë në një kohë kur jeta private e Barron është bërë më shumë objekt i vëmendjes së mediave amerikane. Ai ka zgjedhur një jetë larg ekspozimit publik dhe, sipas raportimeve, lëvizjet e tij shoqërohen me masa të larta sigurie për shkak të kërcënimeve ndaj familjes Trump.

Zyra e Melania Trump ka kërkuar më herët që detajet mbi jetën private të Barron të mos publikohen, duke iu referuar kërcënimeve të fundit ndaj tij.

Barron është shfaqur rrallë në publik gjatë muajve të fundit. Paraqitet e tij të fundit të njohura përfshijnë finalen e Kupës së Botës 2026 në Nju Xhersi dhe një event UFC të zhvilluar në Shtëpinë e Bardhë.

Pavarësisht vëmendjes ndaj jetës së tij private, Melania Trump nuk e përshkroi marrëdhënien me të birin si konfliktuale. Ajo u përqendrua te ndryshimi i natyrshëm i jetës familjare, ndërsa Barron është rritur dhe ka nisur jetën e tij si i rritur, ndërkohë që angazhimet e prindërve në Shtëpinë e Bardhë e bëjnë më të vështirë që familja të kalojë kohë së bashku.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

12:30 Bota

[Lula ndalon lojërat e fatit online përpara zgjedhjeve presidenciale në Brazil](#)

12:20 Bota

15 mijë \$ për çdo ushtar amerikan, oferta e pazakontë e Polonisë për SHBA-të

11:10 Bota

[Ukraina drejt legalizimit të pornografisë, nisma e bujshme synon të sjellë miliona për luftën](#)

10:50 Bota

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.